



Rrjeti i Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

RrGK: Letër avokuese për buxhetin për mbrojtjen dhe trajtimin e viktimave të dhunës me bazë gjinore dhe QPS-të

Prishtinë, 20 tetor 2022

Sot, Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) ia ka adresuar një letër avokuese për buxhetin për mbrojtjen dhe trajtimin e viktimave të dhunës me bazë gjinore dhe për Qendrat për Punë Sociale (QPS) Kryeministrit të Kosovës Albin Kurti, Ministrit të Financave, Punës dhe Transfereve Hekuran Murati, Ministres së Drejtësisë Albulena Haxhiu dhe Drejtorit të Departamentit për Punë Sociale dhe Familjare, Mentor Morina.

Në mënyrë që të sigurohet trajtimi i dinjitetshëm i viktimave të dhunës me bazë gjinore, në pajtim me kornizën ligjore, **RrGK ka kërkuar nga qeveria** që Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve të rrisë buxhetin e alokuar për QPS-të, në koordinim me komuna, në mënyrë që të ngriten kapacitetet e tyre duke i funksionalizuar qendrat ashtu siç është e përcaktuar në kornizën ligjore përkatëse dhe programin e qeverisë si dhe këto ndryshime, të reflektohen në amendamentimet e planifikuara të Ligjit për Financa të Pushtetit lokal. Po ashtu është kërkuar që të ngrisë buxhetin e alokuar për QPS-të në kategorinë Paga dhe Mëditje (rreth 456,000 €) në mënyrë që të punësohen të paktën dy punëtorë socialë më tepër në çdo komunë, dhe të njejtit të **fokusohen vetëm në trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore**. Është kërkuar edhe që të krijohen fonde emergjente në Policinë e Kosovës dhe në QPS me qëllim të plotësimit të nevojave emergjente të viktimave gjatë trajtimit të rasteve të dhunës.

Letrën e plotë avokuese mund ta lexoni në vijim:

I nderuar Kryeministër i Republikës së Kosovës, z. Albin Kurti,
I nderuar Ministër i Financave, Punës dhe Transfereve, z. Hekuran Murati,
E nderuara Ministre e Drejtësisë, znj. Albulena Haxhiu,
I nderuar Drejtor i Departamentit për Punë Sociale dhe Familjare, z. Mentor Morina,

Raportimet e rasteve të dhunës ndaj grave dhe vajzave, në veçanti ato të dhunës seksuale, janë në rritje e sipër. Sipas Institutit të Mjekësisë Ligjore, 85% e viktimave të dhunës seksuale nga viti 2019-2021 ishin të mitura. Qeveria aktuale e Kosovës e ka përsëritur disa herë se mirëqenia sociale është një nga prioritetet kryesore të saj, përfshirë edhe në programin e saj qeverisë. Ndërkaq, shërbimet sociale, e përkatësisht mekanizmat koordinues lokal për mbrojtjen dhe trajtimin e viktimave të dhunës me bazë gjinore vazhdojnë të operojnë në kushte të vështira.

Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) kërkon të **fuqizohen mekanizmat koordinues lokal për mbrojtjen dhe trajtimin e viktimave të dhunës me bazë gjinore, konkretisht, qendrat për punë**

sociale në bazë të obligimeve të Qeverisë ndaj Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në favor të zbatimit të Konventës së Stambollit për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje, Strategjisë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave (SKMDhFDhG), Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, dhe Programit të Barazisë Gjinore.

Sipas Ligjit Nr. 02 L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare, Qendra për Punë Sociale (QPS) si institucion publik i nivelit komunal është kompetent për mbrojtjen e të gjithë qytetarëve në nevojë për shërbime sociale. Në këtë aspekt, QPS-të janë përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve, e rrjedhimisht edhe për mbrojtjen e grave dhe vajzave nga të gjitha format e dhunës deri në riintegrimin e tyre në shoqëri. QPS-të kanë rol thelbësor në parandalimin, mbrojtjen dhe riintegrimin e viktimave të dhunës, sidomos për fëmijët vajza. Mirëpo, bazuar në hulumtimin e RrGK [Nga Ligjet në Vepra](#), QPS-të nuk kanë buxhet apo kapacitete të mjaftueshme të operojnë detyrat e tyre, të përcaktuara me kornizën ligjore të Kosovës. Si pasojë:

- QPS-ve u mungojnë burimet njerëzore për të menaxhuar të gjitha rastet që u janë caktuar;
- Meqenëse u mungojnë burimet njerëzore, menaxhimi i rasteve nga punëtorët social është i dobët, e njëherit shpesh shtyen gratë dhe fëmijët të kthehen në ambiente të dhunës;
- Infrastruktura e dobët krijon pamundësi për të monitoruar mirëqenien e fëmijëve dhe për të siguruar një mjedis të sigurt për të ndihmuar viktimat;
- QPS-ve u mungon hapësira e mjaftueshme dhe qasja në transport të besueshëm, për të arritur me kohë tek viktimat, seancat gjyqësore apo për t'i realizuar vizitat sipas detyrës.

Meqenëse buxheti për QPS-të ekzekutohet sipas kërkesave buxhetore të komunave, rol shumë të rëndësishëm në fondet për këto institucione luan edhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve. Sipas Ligjit Nr. 08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, nuk ka ndonjë linjë specifike për financimin e QPS-ve, mirëpo ekziston një linjë për Politikën Sociale dhe Shërbimet Sociale për secilën organizatë buxhetore në nivel lokal nga e cila financohen edhe QPS-të.

Buxheti total i alokuar për shërbime sociale nga të gjitha komunat është 8,013,787 € me një mesatare prej 222,605 € dhe me një medianë 95,600 €. Nga ky buxhet, 2,785,522 € janë të alokuara në kategorinë e buxhetit 'Paga dhe Mëditje'. Duke marrë parasysh se janë rreth 464 të punësuar nëpër komuna për shërbime sociale (mesatarisht 13 për komunë), punësimi i të paktën dy punëtorëve më tepër në çdo komunë, specifikisht për trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore, duke përfshirë dhunën seksuale dhe dhunën në familje, do të kushtonte gjithsej rreth 444,000 € më tepër në vit për Qeverinë e Kosovës. Idealisht, komuna më e madhe në territorin e Kosovës, Prishtina, ka nevojë për dyfishin e shumës që do të ishte rreth 12,000 € më tepër në vit.

Në mënyrë që të sigurohet trajtimi i dinjitetshëm i viktimave të dhunës me bazë gjinore, në pajtim me kornizën ligjore, **RrGK kërkon nga qeveria që:**

- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve të rrisë buxhetin e alokuar për QPS-të, në koordinim me komuna, në mënyrë që të ngriten kapacitetet e tyre duke i funksionalizuar qendrat ashtu siç është e përcaktuar në kornizën ligjore përkatëse dhe programin e qeverisë; tutje, këto ndryshime, të reflektohen në amendamentimet e planifikuara të Ligjit për Financa të Pushtetit lokal;
- Të ngrisë buxhetin e alokuar për QPS-të në kategorinë Paga dhe Mëditje (rreth 456,000 €) në mënyrë që të punësohen të paktën dy punëtorë social më tepër në çdo komunë, dhe të njejtit të **fokusohen vetëm në trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore;**
- Të krijojë fonde emergjente në Policinë e Kosovës dhe në QPS me qëllim të plotësimit të nevojave emergjente të viktimave gjatë trajtimit të rasteve të dhunës.

Ne gjithashtu bëjmë thirrje për përfshirjen e vazhdueshme të linjës buxhetore, veçanërisht për strehimoret, si ofruese shërbimesh të licencuara që ofrojnë shërbime të kërkuara nga Konventa e Stambollit.

Shpresojmë se këto kërkesa do të përkthehen në veprime konkrete me qëllim të mbrojtjes së grave dhe vajzave në Kosovë.

Ne jemi të gatshme të takohemi për të diskutuar në detaje këto rekomandime.

Sinqerisht,

Igballe Rogova
Drejtore Ekzekutive
Rrjeti i Grave të Kosovës